

Musine Kokalari: Kryeneçe për të vërtetën!

Nga Albert P. Nikolla

Sa na përket neve të tjerëve, jemi rreshkur në këta dhjetëvjeçarë gënjeshtresh dhe kemi një të tillë etje për të vërtetën, sa çdo pikë e ndjesisë së saj në fytyrë, na mjafton për t'u dridhur nga gëzimi dhe me ofshamë të themi: "Më në fund" ...A . Solženicyn. Frymëmarrja e ndërgjegjes.

Shprehja e sipërpërmendur e A. Solženicyn, përmbledh ndjenjën që kam provuar kur sapo pata mbaruar leximin e Jeta ime universitare të Musine Kokalarit. Duke lexuar librin është e qartë menjëherë, që filli i kuq që përshkon shkrimin është kërkimi i së vërtetës. Në ditarin e saj mendimi është i qenësishëm. Kemi përballë një grua intelektuale, brilante e të pjekur, dhe duke u nisur nga mosha e saj e re mahnitja përballë kësaj sjelljeje është e natyrshme!

E nisa me këtë refleksion për konceptin e së vërtetës, sepse vetë Kokalari parathotë në libër të ardhmen e jetës së saj: një betejë e pambarimtë për t'i qëndruar besnike së vërtetës, me çdo çmim, pavarësisht kushtëzimeve:

Nuk dinë të sillen ndryshe, kjo shfaqje për ta është shumë ndjellëse. Është qëllimi. Flasin aq shumë, veç për të fshehur të vërtetën ... ()... E lozin mjeshtërisht rolin e shpërfillësit. Vogëlsira dhe tradhti – jeta e tyre. Gënjeshtër për shkak të mungesës së aftësisë.

Kokëfortësia, kryelartësia!

Disa elemente të pranishme në librin e M. Kokalarit më duken antropologjikisht tipike për realitetin kulturor shqiptar. Mendoj se kokëfortësia është një trajtë antropologjike mjaft e dallueshme e shqiptarit të mesëm; por kthehemi te Kokalari: kjo grua kokëfortësinë e saj e kanalizon në të mirë dhe në kërkim të së vërtetës dhe në çjerrjen e maskës së antipodit të saj, falsitetit.

Nuk kalojnë as tri ditë dhe vijnë e më thonë të tjera thashetheme. Kësaj radhe po, që nervozohem vërtet dhe dua të di të vërtetën prej tij. Kjo mënyra e të folurit pas shpine, më kish bërë të vuaja shumë dhe ndieja nevojën të dija të vërtetën, t'i jepja fund kësaj rrëmuje.

Tashmë e kam kuptuar se ky burrë s'ka thënë kurrë të vërtetën gjatë gjithë jetës së tij. Idetë e tij, ekzistenca e tij, ashtu si e nënës së tij, ishin të bazuara mbi gënjeshtër.

Ajo nuk del kundër askujt, edhe kur e pëson rëndshëm. Sugjerimit që i bën e ëma e të fejuarit për hakmarrje ndaj vajzave që e kanë lënduar, ajo i përgjigjet: "Unë nisem sepse duhet të nisem, kam mjaft punë dhe nuk bëj kurrë asgjë për mllëf". Kryelartësia është përherë e pranishme në jetën e Musinesë. Antropologu italian Mauro Geraci e vë në dukje këtë tipar në studimin e tij Prometeo in Albania:

Musineja nuk trajton për asgjë. I përgjigjet izolimit të imponuar me një tjetër izolim intelektual dhe moral ku e ku më të madh, kozmik dhe të pacenueshëm që i çorienton burgosësit, duke ua asgjësuar çdo qëllim shantazhimi. Izolimi, që shkrimtarja e përsos në burg si armën më sekrete dhe të përshtatshme për kundërvënien, është shkak i forcës së një autoriteti që shfaqet unik, i pakorrupsueshëm, si çeliku.

Pas rënies së komunizmit, ishte mjaft e përhapur dukuria e të ndarit në grupe e vetë të përndjekurve të regjimit, po ashtu edhe prirja për të anashkaluar njëri-tjetrin. Musine Kokalari është e përndjekura per eccellenza. Pa vënë në dyshim respektin për vuajtjen e secilit person të përndjekur nga regjimi, është e rastit dhe e ndershme të bëhet një dallim, pasi Musineja është përndjekur pastërtisht për idetë e saj të qarta, të

ndjera dhe konsekuente kundrejt regjimit; ndryshe nga të tjerë, që ranë nga rangjet e larta për shkak të “gabimeve” në vijën ideologjike ndërsa kryeson angazhimin e tyre politik gjatë regjimit.

Thirrja etnografike dhe antropologjike.

Mundësia për të studiuar në Itali ishte për M. Kokalarin një mundësi e madhe për të njohur botën nëpërmjet studimit dhe takimit etnografik me një realitet të ndryshëm nga i veti. Edhe pse ajo pohon se ndihet e huaj kundrejt kulturës perëndimore, ajo në të vërtetë është perëndimore me titull të plotë: Musineja e re udhëton për arsye studimi rreth një mijë kilometra larg shtëpisë. Për pushimet verore udhëton më avion nga Tirana në Korçë. Nuk gjejmë ndryshime thelbësore në stilin e saj të jetës në përballje me vajzat e tjera, po të mos ishte për “ndjenjën e përkatësisë”. Pavarësisht kësaj, impakti kulturor me Italinë ishte një mundësi e madhe. Në lidhje me këtë antropologu italian E. De Martino pohon se “skandali fillestar i qasjes etnografike” është në fakt një mundësi: “në këtë kuptim, qasja etnografike për njeriun perëndimor na ofron rastin për të marrë në shqyrtim ndërgjegjen në mënyrë rrënjësore; një shqyrtim rezultati i të cilit ndërmjetëson një reformë të dijes antropologjike dhe të kategorive vlerësuese të saj ...”[1].

Vetë Musineja pohon se impakti i parë me Italinë ishte i vështirë:

Natyrshëm nuk kam prirje për gjuhët e huaja, ndaj druaja gjithnjë se mund të bëja gabime dhe për këtë më vinte turp; prandaj përpiqesha të përgjigjesha në mënyrën më lakonike të mundshme, mundësisht thjesht me një po ose jo. Nga ana ime nuk nisja kurrë një bisedë në tavolinë. Rezultati: kohët e para nuk hapja gojë. E gjithë kjo duket disi absurde kur e tregon, por asokohe vuaja tmerrësisht shumë.

Libri tregon se Musineja është një vëzhguese mjaft e vëmendshme. Mjaft të mendojmë për vizitat në muzetë e Romës për të kuptuar se sa interesohet edhe për detajet më të holla, që i shpëtojnë syrit të një vizitori normal:

Përballë sarkofagut, ku qëndrojnë të shtrirë dy të vdekurit, në shtratin bashkëshortor, mora vesh kuptimin e përtej varrit. Gruaja mbulohet nga përhura, burri ka mjekër, të dy kanë këpucë. Ajo shprehi e fytyrës së tyre, me profilin e mprehtë dhe sytë poshtë i bën të duken njerëz dinakë.

Thirrja etnografike do të shënjojte pjesën më të mirë të shkrimeve të saj. Qysh në moshë të hershme joshet nga përmbledhja e përrallave dhe këngëve popullore të përcjella gojarisht në familjet shqiptare. Ngjall interes fakti që ajo bën një hap më tej sa i takon vëzhgimit të thjeshtë etnografik: analizë refleksioni antropologjik. Shumë interesante janë refleksionet për çështjen e “relativizmit kulturor”, anën teorike të të cilave ajo me siguri nuk e njeh, por bashkë me këtë aspekt e paraprijnë dhe e tregojnë refleksionet e saj:

Nisur nga besimi i të tjerëve dhe shtyrë nga instinkti, u ula të studioj për herë të parë doktrinën e fesë sime. Kjo gjë m’u duk shumë interesante. Kur isha në gjendje të arsyetoja mbi këtë doktrinë, atëherë kuptova pse më ishte dukur e çuditshme: sepse një besim i lindur dhe zhvilluar në një ambient oriental, interpretohej këtu në bazë të mendësisë perëndimore.

Antropologu francez M. Augé pohon se “ajo çka e dallon etnologun është metoda: vëzhgimi sistematik, vetmitar dhe i përzgjat” dhe Kokalari vepron duke ndjekur pikërisht këtë metodë. I pëlqen shumë vetmia, aq shumë sa arrin të shprehë një ide interesante për veprat individuale dhe ato të masës:

Secili prej nesh përpiket të mbizotërojë, të zotërojmë dhe të transformojmë dhe kjo bëhet me punë, që na bën të lirë. A mos është kjo vallë arsyeja pse punët individuale janë më të mira se ato të masës? Atëherë arrij në përfundimin se aspirata ime më e mirë dhe më e madhe është ajo që të aftësohem dhe të vetëmjaftohem. Vetëm kështu mund të ndihmohet sinqerisht njerëzimi. Të mos kesh asnjë miqësi të

veçantë, por të duash secilin; të kesh rastin të reflektosh dhe herë-herë të dyshosh në ke të drejtë: vetëm në këtë mënyrë tregojmë një interes të singertë kundrejt shoqërisë.

Një profeci që do të vërtetohej pas pak vitesh, pasi u shtrëngua të jetojë në vetmi kundër një regjimi që shpallte se pushteti iu takonte “masave”.

Ndjenja e fesë.

Nga libri duket e vështirë të pohosh se M. Kokalari është një besimtare prakticante apo jo. Vëren e vëmendshme ndjenjën fetare të italianëve dhe kjo e shtyn të thellojë besimin e saj mysliman. Edhe me këtë perspektivë ajo zbulon sensin e saj kritik antropologjik kur gjykon fenë e tjetrit me parametrat e fesë së saj.

Teologu gjerman R. Otto pohon se në mënyrë që të flasim për një përvojë autentike të besimit fetar duhet të kemi parasysh së paku dy elemente: tremendum et fascinans. E pra, M. Kokalari eksperimenton me titull të plotë të ashtuquajturin “fascinans”, ndërsa nuk duket në libër elementi tjetër: “tremendum”.

Gjatë këtyre shëtitjeve më pushtojnë kundrimet, dhe herë pas here ndalesha mbi urën e lashtë romake dhe shihja ujin e lumit që rridhte duke marrë me vete një pafundësi barërash të këqija dhe plehrash. Në reflekset e ujit, jeta më dukej një ëndërr, dhe në këto orë vetmie isha krejtësisht vetvetja dhe ndieja brenda vetes një trazim të ëmbël; përballë gjithë kësaj bukurie admiroja veprat e mëdha të Zotit.

Megjithatë mund të pohohet se ajo përjetonte një ndjenjë anjostike, megjithëse është e vështirë të gesh mirëfilli një referencë të qartë transcendentale. Ajo e njeh mirë ndjenjën e transcendentales, sepse e përdor edhe në tezën e saj për Naim Frashërin, por nuk shih një të “përtejme” pas vdekjes së njerëzve:

Kështu është edhe jeta e njeriut: lind, shkon drejt pjekurisë, vdes; ndërkaq të tjerë vijnë pas nesh. Çdo vit i jetës sonë që kalon, nuk kthehet më, si petalet e trëndafilave, që era merr me vete një e nga një dhe prej tyre asgjë nuk mbet, veç pluhurit. Vetëm natyra është e përjetshme, me format e saj të ndryshueshme. Edhe ekzistenca jonë nuk është tjetër veçse një përparim i botës dhe i kohës.

Gjithsesi përvoja fetare e tërheq. Pohon se gjen paqe të brendshme kur dëgjon lutjen e Mbrëmësore në Kishën e Santa Maria degli Angeli: “...hyja në kishën Santa Maria degli Angeli. Ulesha në një qoshe dhe pushoja në qetësi, në një gjendje lumturimi; sidomos mbrëmjeve kur kisha është plot hije dhe mbushej nga zërat delikatë të të rinjve që këndojnë Mbrëmësoren”[2].

Thirrja politike në një klimë kulturore tribale

Në shënimet e saj për jetën universitare shfaqet krejt pak thirrja politike e M. Kokalarit. Madje mund të thuhet se kishte një refuzim për politikën, meqenëse ajo nuk është e përputhshme me vetminë dhe me kërkimin personal të së vërtetës, çështje aq të shtrenjta për Kokalarin: “Kushtet, shtetërore dhe politike, edhe pse janë miqësore, shpeshherë zgjojnë në qenien tonë, mbase edhe gabimisht, disa interpretime pak të këndshme”.

Musineja është e bindur se ekziston një lidhje e brendshme mes politikës dhe hipokrizisë dhe për këtë arsye, gjykimi i saj për politikanët është negativ. Mbase pikërisht në këtë gjykim negativ për politikanët duhet ta inkuadrojmë thirrjen e saj të veçantë për politikën në vetvete, e cila është e papërputhshme me mënyrën se si bëhet politika në kohën kur ajo jeton:

Në këto qendra të një rëndësie të madhe dhe qendra të politikës botërore, ku ndodhin shumë gjëra sensacionale, takohen persona që flasin me zë të lartë dhe me vetëbesim për përmirësimin e shoqërisë. ... E kanë hapin e lehtë dhe e fshehin atë që bëjnë në privatësinë e tyre; mendojnë veç për vete. Në këto shoqata

me lidhje shoqërore për të mirën e njerëzimit dhe të qytetërimit nuk ka gjë tjetër veçse një marrëveshje të ndërsjellë për një mijë interesa të vegjël, një mijë vanitete dhe një luftë të përhershme.

Musineja vjen nga një familje e pasur, prandaj, nisur edhe nga vetë natyra tribale e shoqërisë, ajo ka njëfarë pushteti politik për shkak të lidhjeve të forta. I vëllai është në shërbim diplomatik për llogari të shtetit shqiptar. Ndjeshmëria e saj e lartë për lirinë dhe të vërtetën, bën që ajo të jetë kundër fashizmit dhe komunizmit dhe të gjejë një rrugë të mesme në social-demokracinë. Mund të thuhet me bindje se thirrja e saj politike është moderne dhe prek thelbin e çështjes së ndershmërisë në shërbimin ndaj bashkësisë: "... të duash secilin; të kesh rastin të reflektosh dhe herë-herë të dyshosh se ke të drejtë: vetëm në këtë mënyrë tregojmë një interes të sigurt kundrejt shoqërisë".

Gruaja myslimane, në shoqëritë lindore dhe komplekse (edhe realiteti shqiptar i viteve '30 ishte i ngjashëm) ka shumë pushtet, por ky nuk është një pushtet që duket shumë në sferën publike. Mjaft t'iu referohemi studiuesve F. Cardini, dhe O. Carrè, njohës të thellë të realitetit islamik dhe oriental, që të mund të pohojmë se gruaja ka një rol kyç në këto shoqëri. Ndaj edhe thirrja politike e Kokalarit nuk del në sipërfaqe rastësisht, por nga një realitet i mbarsur edhe pse plot me mistere dhe kundërthënie.

Forca e heshtjes. Nga heshtja e vullnetshme te heshtja e imponuar

Antropologu Mauro Geraci ia ka dalë mbanë ta njohë thellë Shqipërinë. Është surprizuese analiza e tij antropologjike shumëdimensionale e letërsisë dhe e traditave shqiptare, deri në atë pikë sa nuk i shpëtojnë as hollësitë më karakteristike të kulturës sonë komplekse. Geraci ka vërejtur edhe një element të rëndësishëm, që besoj është tipar i fortë i shqiptarëve të mençur: përdorimi i heshtjes. Musineja është e heshtur. Ky është preludi i një urtësie të thellë që karakterizon jetën e saj deri në fund. Geraci vëren:

Musineja nuk trajtoi për asgjë. E shoqja e historianit të madh të gjuhës shqipe Eqrem Çabej, që kaloi me Musinenë disa ditë në të njëjtën qeli, dëshmoi më pas se si ajo nuk fliste me asnjëri, se si e përballonte dënimin me një heshtje të padepërtueshme edhe kur e torturonin.

Edhe në shënimet e Musinesë del e qartë zgjedhja e saj për heshtje dhe vetmi. Për këtë arsye, karakteri i saj shumë reflektiv priret drejt përpunimit të çdo vëzhgimi në të cilin ndeshet:

Është kaq bukur të jesh vetëm, krejt vetëm dhe të humbasësh në mendime, duke parë pa dallim çdo gjë që na rrethon, të dëgjosh pa u vënë veshin gjërave dhe të mbyllësh sytë sikur po fle dhe pastaj të zgjohesh... të ëndërrosh. Çfarë? Nuk mund të përkufizohet! Është vetë zemra që gëzon dhe kënaqet, pa e ditur arsyen. Shpirti ndizet nga kundrimi i modeleve hyjnore dhe lartësohet.

Studiuesit kanë vërejtur se heshtja është elementi konstant i vuajtjeve të imponuara nga diktaturat. M. Kokalari do të kalojë nga "heshtja e vullnetshme" si reflektim i urtisë së saj, në heshtjen torturë: "çdo shoqëri në çdo kohë e ka përdorur heshtjen si ndëshkim, duke burgosur ata që i konsideronte fajtorë. ... Qysh se bota ekziston heshtja është pjesë e torturës".

M.Kokalari e përdor "heshtjen e vullnetshme" si pjesë të arsenalit të saj të drejtësisë, por edhe "heshtjen e imponuar si torturë" e përdor për të na dhënë një ndër shembujt më brilantë të qëndresës dhe dinjitetit më të lartë njerëzor.

[1] De Martino. E. La fine del mondo. Contributo all'analisi delle apocalissi culturali. Einaudi. Torino. 1977, pag. 391